



Pranuar / Dorezuar Received / Delivered	15.06.2022	viti god year	2
Organ / Njësia Org. / Jednica Org. / Unit	SKRMJHA	Shtup / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
	3513/2022		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.443/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.443/2022 të datës 06.05.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi [redacted]

[redacted] në Komunën e Prishtinës, në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.06.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.443/2022 e datës 06.05.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]**

**II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër DBNJ-Nr.03/2022 të datës 19.04.2022 të Zyrës së Personelit në Ministrinë e Drejtësisë.**

**A r s y e t i m**

Ministria e Drejtësisë duke u bazuar në dispozitat e nenit 38 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 40 të Rregullosës (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 07.03.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 22.03.2022 ka shpallur konkursin për lëvizje brenda kategorisë lidhur me pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike”, për klasën e pozitës Drejtues i ulët 1.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, me datën 06.04.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër DBNJ-Nr.02/2022, sipas të cilit ankuesi është njoftuar se nuk është

përfshirë në listën e ngushtë, në konkursin për lëvizje brenda kategorisë për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike”.

Kundër vendimit për mos përfshirjen në listën e ngushtë të datës 06.04.2022, ankuesi me datën 12.04.2022, ka parashtruar ankesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë. Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Drejtësisë me datën 19.04.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër DBNJ-Nr.03/2022, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar lidhur me mos përfshirjen në listën e ngushtë dhe ka lënë në fuqi Vendimin Nr.02/2022 të datës 06.04.2022.

Ankuesi kundër Vendimit me numër DBNJ-Nr.03/2022 të datës 19.04.2022, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes e-mailit zyrtar [ankesa.kpmsk@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmsk@rks-gov.net) me datën 06.05.2022, ka dorëzuar ankesën me numër të protokollit 2661/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljes së dispozitave ligjore, me pretendimet ankimore për mos përfshirje në listën e ngushtë nga ana e Njesisë së Personelit në Ministrinë e Drejtësisë si dhe kërkon që ky konkurs të anulohet nga na e Këshillit.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:2661/2022 të datës 06.05.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 19.04.2022 Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë; Vendimin e datës 06.04.2022 Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë; Konkursin e datës 22.03.2022 me numër të referencës RN00008455; Dosjen e ankuesit së bashku me dokumentet e bashkangjitura lidhur me përvojën profesionale dhe atë të punës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 17.05.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 23.05.2022 nga Ministria e Drejtësisë së bashku me dokumentet e bashkangjitura të lëndës; Ankesën e ankuesit të datës 12.04.2022 e parashtruar në Njësinë e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së drejtësisë; Kërkesën e datës 13.06.2022 për prova shtesë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë të datës 13.06.2022 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës së bashku me akt emërimit të datës 05.03.2013 të ankuesit

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike”, kanë qenë: *Diplomë të studimeve universitare në Fakultetin e Teknologjisë Informative, Ekonomik, Komunikacion Krugor dhe Transport me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale.* Ndërsa kushtet për lëvizjen brenda kategorisë

dhe kërkesat e veçanta për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike", kanë qenë:

*Të jetë nëpunës civil i të njëjtës kategori për të cilën aplikon*

*Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende*

*Te jetë vlerësuar të paktën 'mirë' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.*

Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, bazuar në kriteret e konkursit po ashtu edhe dëshmitë e bashkangjitura nga ankuesi, në pajtim me nenin 45 paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka bërë vlerësimin paraprak nëse kandidatët kanë plotësuar kushtet e konkursit, rrjedhimisht në bazë të kësaj ankuesi me vendim është njoftuar që nuk ka plotësuar kushtet e konkursit me arsyetimin se nuk është në kategori të njëjtë për të cilën ka aplikuar, ngase pozita "Inxhinier i Makinerisë" pranë Drejtorisë Qendrore të Shërbimit Korrektues të Kosovës të cilën e mban ankuesi sipas e-mailit zyrtar të datës 04.04.2022 konfirmohet se i përket kategorisë profesional 1.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, janë përcaktuar kriteret për secilën kategori të shërbimit civil, konkretisht pozita "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike", *hyn në kategorinë e nivelit Drejtues i ulët 1 sipas shtojcës Nr. 1/6 , ndërsa pozita e ankuesit "Inxhinier i Makinerisë të cilën e mban sipas akt emërimit të datës 05.03.2013 ,hyn në kategorinë e nivelit Profesional 1 sipas shtojcës Nr.1/8, të kësaj rregulloreje*, sepse ankuesi në bazë të akt emërimit të datës 05.03.2013 për pozitën të cilën e mban si "Inxhinier i Makinerisë" pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës realizon pagën sipas koeficientit 8.5 dhe i njëjti sipas përshkrimit të detyrave të punës është nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të njësisë së inxhinjeringut të këtij institucioni, prandaj meqenëse ankuesi, nuk ka ofruar dëshmi që me rastin e aplikimit në bazë të dëshmisë së akt emërimit dhe pozitës të cilën e mban nuk i përket kategorisë së njëjtë për të cilën është zhvilluar procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës siç është kërkuar në konkurs pra Drejtues i ulët 1 me koeficient 9, atëherë sipas normave ligjore i njëjti edhe nuk i ka plotësuar kushtet e përcaktuara të konkursit, rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Drejtësisë, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër DBNJ-Nr.02/2022 të datës 06.04.2022 për mos përfshirje në listën shkurtër të ankuesit ka vepruar në pajtim të plotë me nenin 39 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, shtojcën Nr. 1/6 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, nenin 15 dhe nenin 40 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, andaj edhe pretendimi i ankuesit që i njëjti i ka plotësuar kushtet e konkursit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike "sa i përket lëvizjes në kategori është i pabazuar.

Andaj pas gjithë këtyre, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me numër DBNJ-Nr. 02/2022 i datës 06.04.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, është nxjerrë në përputhje me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me nenin 15 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për

Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse ka vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe juridike.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.443/2021, datë 15.06.2022.

Ardita Perçuku-Shyti

  
Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Drejtësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

